



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.278/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Beker, në çështjen përbarimore të kreditorit “IPKO TELECOMMUNICATIONS” L.L.C, me NRB:70064420, me seli në Prishtinë, rruga “Zija Shemsiu” nr.34, kundër debitorit “NSH Prishtina-2000”, me NRB:70124047, me seli në Prishtinë, lagjja Bregu i Diellit Il.3, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.539/14 të datës 02.12.2014 të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “NSH Prishtina-2000”, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.539/14 i datës 02.12.2014 i Përbaruesit Privat Destan Bujupaj për pjesën e detyrimit në shumën prej 675.86 €.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit “NSH Prishtina-2000”, dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr.539/14 i datës 02.12.2014 i Përbaruesit Privat Destan Bujupaj sa i përket shumës prej 391.22 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “IPKO TELECOMMUNICATIONS” L.L.C, ndaj debitorit “NSH Prishtina-2000”, sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.539/14 të datës 02.12.2014, për shumën prej 675.86 €.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.539/14 të datës 02.12.2014, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.0167052 e datës 30.11.2012, Nr.0162965 e datës

31.10.2012, Nr.0159061 e datës 30.09.2012, Nr.0155145 e datës 31.08.2012, Nr.0151293 e datës 31.07.2012, Nr.0147460 e datës 30.06.2012, Nr.0143806. e datës: 31.05.2012, Nr.0136903. e datës: 31.03.2012, Nr.0129441. e datës 31.01.2012, Nr.0116076 e datës 30.09.2011, Nr.0110758 e datës 31.08.2011, Nr.0109632 e datës 31.07.2011, Nr.0106445 e datës 01.07.2011, Nr.0103297 e datës 01.06.2011, Nr.0100039 e datës 01.05.2011, Nr.0084911 e datës 01.12.2010; duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit shumën prej 1,067.08 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, ndërsa nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin, kreditori propozon që të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogaritjen e veçantë bankare të Zyrës Përmbartimore dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, në tërë masën pasurore të debitorit, derisa të kryhet tërësisht obligimi i të njëjtit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se propozimi i kreditorit është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD) dhe se kreditori e ka humbur të drejtën të kërkoj përmbushjen e borxhit në procedurë përmbartimore. I ka propozuar Gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor, si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim me të cilën ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit për shkak se debitori përmes veprimeve konkluzive ka pranuar borxhin përmes pagesave, në këtë rast kemi pasur krijimin e ndërprerjes së institutit të parashkrimit. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar prapësimin.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas vendimit AC.nr.1504/2017 të datës 30.01.2019, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbnim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbnimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentet e besueshme – Faturat e cekura më të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të faturave dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat Nr.0116076 e datës 30.09.2011, Nr.0110758 e datës

31.08.2011, Nr.0109632 e datës 31.07.2011, Nr.0106445 e datës: 01.07.2011, Nr.0103297 e datës 01.06.2011, Nr.0100039 e datës 01.05.2011, Nr.0084911 e datës 01.12.2010; në shumën prej 675.86 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbaram është paraqitur me datë 02.12.2014, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit / arritjes për pagesë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit për faturat e lartcekura, është parashkruar, andaj pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe për shumën prej 675.86 €, e anuloi urdhrin për përmbaram P.nr.539/14 të datës 02.12.2014 të Përmbaramesit Privat Destan Bujupaj, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa sa i përket borxhit sipas faturave Nr.0167052 e datës 30.11.2012, Nr.0162965 e datës 31.10.2012, Nr.0159061 e datës 30.09.2012, Nr.0155145 e datës 31.08.2012, Nr.0151293 e datës 31.07.2012, Nr.0147460 e datës 30.06.2012, Nr.0143806. e datës: 31.05.2012, Nr.0136903. e datës: 31.03.2012, Nr.0129441. e datës 31.01.2012; Gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën prej 31.01.2012 deri më datë 30.11.2012, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 02.12.2014, ka ushtruar propozim për përmbaram, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën e cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit e refuzoi prapësimin e debitorit dhe e la në fuqi urdhrin për lejimin e përmbaramit P.nr.539/14 të datës 02.12.2014 të Përmbaramesit Privat Destan Bujupaj, për shumën prej 391.22 €, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e

Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare, me të cilin përcaktohet se: “*Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbareimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbareimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.278/22 datë 18.08.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.